# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 01/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet: 191 dhe 193 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 192, 194, 195 dhe 196 elektronike/ korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 02/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZhKE) për Projektin "Banimi Social Adekuat".

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 03/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës me nr. Prot.331 të datës 15.03.2024, jep mendim lidhur me Nismën legjislative për "Projektligjin për kripto- asetet", si në vijim:

   1.1. Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se Nisma legjislative nga pika 1 e këtij Vendimi synon të krijojë një kornizë rregullative për kripto-asetet dhe në përgjithësi, iu përmbahet standardeve të BE-së të përcaktuara me Rregulloren (BE) 2023/1114;

   1.2. Ministria e Punëve të Brendshme, ofron rekomandime për ndyshimin e neneve të caktuara të nismës legjislative të cekur në pikën 1 të këtij Vendimi;

   1.3. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në mendimin e tij për nismën legjislative të cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, ka vlerësuar se Projektligji për kripto-asetet, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, duke nënkuptuar se një pjesë e aktiviteteve që dalin nga ky projektligj do të mbulohen nga buxheti i Bankës Qendrore të Kosovës.

2. Ky Vendim së bashku me mendimet e institucioneve përkatëse i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Nr. 04/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale për Infermier, Kirurg, Veterinar, Farmacist dhe Mami në Kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë të Lirë të Evropës Qendrore.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 05/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9 Kijevë-Zahaq, Segmenti Dollc-Ramun, Zonat Kadastrale: Dollc, Zajm, Grabanicë, Drenoc, Pjetërq i Epërm dhe Pjetërq i Poshtëm, Komuna Klinë; dhe Zonat Kadastrale: Jabllanicë, Kliçinë, Leshan, Gllaviçicë dhe Ramun të Komunës së Pejës, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/200
Datë: 18.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim për interes publik të parcelave Nr.1504-16 dhe 1504-17 dhe Objektit/Ndërtesës ish prona shoqërore "Pallati i Shtypit - Nderm.Inf.Botuese", për nevoja të Depos Qendrore të Barnave dhe akomodim të administratës së Ministrisë së Shëndetësisë, ZK Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhen nga buxheti i subjektit kërkues/Ministria e Shëndetësisë.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/ Ministria e Shëndetësisë.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/200
Datë: 18.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-208 për Parqet Industriale dhe Teknologjike, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Themelohet Parku industrial dhe teknologjik me emërtimin Park i Përgjithshëm në komunën e Podujevës me kohëzgjatje prej 99 vite.

2. Pronat e paluajtshme më të cilat themelohet Parku industrial dhe teknologjik në vendin e quajtur Livadicë, Komuna e Podujevës, janë të regjistruara në emër të komunës së Podujevës dhe janë në sipërfaqe prej 298314 m$^2$.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 08/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 8 paragrafëve 2 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet vlera e shpenzimeve të transportit detar dhe kontejnerëve në Shtojcën 2. të Udhëzimit Administrativ Nr. 06\2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara, konform listës së çmimeve të përditësuara, si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transferuesve për zbatimin këtij Vendimi.

3. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 11/145 i datës 07.06.2023.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

Dogana e Kosovës, gjatë vlerësimit, analizës, hulumtimeve dhe përcjelljes së trendit të lëvizjes së çmimeve sa i përket shpenzimeve të transportit detar, për shkak të krizës në Detin e Kuq\ kanali i Suezit ka vërejtur ndryshim në ngritje të çmimeve, sidomos atyre nga Azia.

Në këtë drejtim, me qëllim të ndjekjes dhe harmonizimit të çmimeve të transportit detar, Dogana ka rekomanduar .rishikimin e shpenzimeve të transportit detar me kontejnerë. Mbi bazën e këtyre vlerësimeve dhe hulumtimeve të kryera nga njësitë e Doganës së Kosovës dhe mbështetur në nenin 8, paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara, u vendos për rishikim të vlerave të shpenzimeve të transportit detar dhe u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

SHTOJCA 2- Tabela e Shpenzimeve të Transportit Detar me Kontejner
ANNEX 2- Table of expenses of maritime transport with container
ANNEX 2- Tabela pomorskih prevoznih troskovakontejnerom

| **Relacioni- Itinerary - Relacija** | | | **Çmimi sipas llojit të kontejnerit * Price due to container's type * Cena po vrsti kontejnera *** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shteti State Zemlja** | **Porti i nisjes Departure Port Luka polaska** | | **20FT USD** | **Propozimet** | **40FT USD** | **Propozimet** | **45FT USD** | **Propozimet** |
| Algjeri Algeria Alžir | Algiers | | 1900 | 1900 | 2800 | 2800 | 2800 | 2800 |
| Angli England Engleska | | | 1200 | 1200 | 2000 | 2000 | 2000 | 2000 |
| Argjentinë Argentina Argentina | Bueno Aires | | 3504 | 3504 | 5600 | 5600 | 5600 | 5600 |
| Australi Australia Australija | Sydney | | 2400 | 2400 | 2960 | 2960 | 3000 | 3000 |
| Bangladesh Bangladesh Bangladeš | Chittagong | | 2200 | 2200 | 3200 | 3400 | 3200 | 3450 |
| Brazil Brazil Brazil | Santos | | 1960 | 1960 | 3200 | 3200 | 3200 | 3200 |
| Egjipt Egypt Egipat | Aleksandri Suez | | 530 780 | 530 780 | 650 1350 | 650 1350 | 650 13500 | 650 1350 |
| Filipine Philiphines Filipinski | Manila | | 1780 | 2300 | 3000 | 4000 | 3000 | 4000 |
| Francë France Francuska | | | 800 | 800 | 1200 | 1200 | 1200 | 1200 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Hollandë<br>Netherland<br>Holandija | | | 675 | 675 | 940 | 940 | 940 | 940 |
| Hong- Kong<br>Hong- Kong<br>Hong- Kong | | | 1840 | 3050 | 2800 | 4550 | 2900 | 4550 |
| India<br>India<br>Indija | | | 940 | 1880 | 3705 | 3450 | 3755 | 3455 |
| Indonezi<br>Indonesia<br>Indonesija | Jakarta | | 2350 | 2350 | 4080 | 4080 | 4080 | 4080 |
| Iran<br>Iran<br>Iran | | | 2200 | 2200 | 3250 | 3250 | 3250 | 3250 |
| Japonia<br>Japan<br>Japan | Fukuyuma | | 2100 | 3050 | 3350 | 4550 | 3350 | 4550 |
| Kanada<br>Canada<br>Kanada | Halifax | | 2640 | 2640 | 4480 | 4480 | 4480 | 4480 |
| Kamboxhia<br>Combadia<br>Kambodzi | | | 1600 | 3050 | 3000 | 4500 | 3000 | 4550 |
| Kina<br>China<br>Kina | | | 1700 | 3050 | 2500 | 4550 | 2550 | 4550 |
| Koreja e Jugut<br>South Korea Južna<br>Koreja | Gwangyang | | 1600 | 3050 | 3000 | 4550 | 3000 | 4550 |
| Liban<br>Lebanon<br>Liban | Bejrut | | 600 | 600 | 900 | 900 | 900 | 900 |
| Malajzi<br>Malaysia<br>Malezija | Port Kelang | | 3072 | 3072 | 4800 | 4500 | 4880 | 4500 |
| Malta<br>Malta<br>Malta | | | 640 | 640 | 960 | 960 | 1000 | 1000 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Portugalia<br>Portugal<br>Portugal | Lisbon | | 1360 | 1360 | 2360 | 2360 | 2360 | 2360 |
| Singapor<br>Singapore<br>Singapur | | | 2040 | 3050 | 3300 | 4500 | 3367 | 4550 |
| SHBA<br>USA<br>SAD | New York | | 2400 | 2400 | 3950 | 3950 | 3950 | 3950 |
| Shri Lanka<br>Sri Lanka<br>Šri Lanka | Colombo | | 2000 | 2000 | 3200 | 3200 | 3200 | 3200 |
| Spanjë<br>Spain<br>Španija | | | 1300 | 1300 | 1760 | 1760 | 1760 | 1760 |
| Tailanda<br>Tailand<br>Tajland | Bangkok | | 3200 | 3200 | 4160 | 4160 | 4160 | 4160 |
| Tajvan<br>Taiwan<br>Taivan | | | 1100 | 1750 | 3082 | 4000 | 3100 | 4100 |
| Tunizi<br>Tunisia<br>Tunis | Rades | | 1650 | 1650 | 2765 | 2765 | 2765 | 2765 |
| Turqi<br>Turkey<br>Turska | Mersin | | 550 | 550 | 700 | 700 | 700 | 700 |
| Vietnam<br>Vietnam<br>Vijetnam | Saigon | | 1750 | 3050 | 3591 | 4400 | 3591 | 4450 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 09/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

# P R O P O Z I M - V E N D I M

**Për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës; përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Fondit Saudit për Zhvillim për projektin "Magjistralja Prishtinë – Mitrovicë"**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për rekomandimin për Presidenten e Republikës së Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Fondit Saudit për Zhvillim për projektin "Magjistralja Prishtinë-Mitrovicë".

2. I rekomandohet Presidentes së Republikës së Kosovës dhënia e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij Vendimi, në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/200
Datë: 18.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

# V E N D I M

**Për rekomandimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për autorizimin e Zëvendëskryeministrit të Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog Z. Besnik Bislimi, për nënshkrimin e amendamentimit Nr. 2. të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2016**

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Zëvendëskryeministrit të Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, z. Besnik Bislimi, për nënshkrimin e Amendamentimit nr. 2 të Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2016.

2. I rekomandohet Presidentes së Republikës së Kosovës dhënia e autorizimit Zëvendëskryeministrit të Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog z. Besnik Bislimi për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij vendimi në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Nr. 11/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 paragrafit 2. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Ligjit Nr. 08/L-061 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Investime për financimin e Projektit "Reagimi i Kosovës ndaj Pandemisë Covid - 19 për NVM-të", Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 10,000,000.00€ (dhjetë milionë euro) për zbatimin e Masës 2.2 "Mbështetje bizneseve për qasje në financa" të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

2. Mjetet e ndara sipas pikës l. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Investime Kapitale", nga projekti "Financim për Ri-kapitalizimin e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive" me kod 15882, burimi i financimit "Klauzola e Investimeve", dhe ndahen në nën-programin "Thesari" me kod 11200 në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", burimi i financimit "Klauzola e Investimeve" (06)

3. Autorizohet Thesari i Kosovës që mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi, t'i transferojë te organizata jo-buxhetore Fondi Kosovar për Garanci Kreditore.

4. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.

5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 12/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Transportit Tokësor të Mallrave të Rrezikshme.

2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 13/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Zejtarisë.

2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 14/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

# V E N D I M

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/24, të datës 14 gusht 2020**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/24, i datës 14 gusht 2020 si në vijim:

   1.1. Pika 3. e Vendimit Nr. 05/24, i datës 14 gusht 2020, zëvendësohet me këtë tekst:

1. Kryeministri, kryesues;
2. Zëvendëskryeministri i parë;
3. Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
4. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve;
5. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
6. Ministrja e Ekonomisë;
7. Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
8. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
10. Ministrja e Drejtësisë;
11. Ministri i Shëndetësisë;
12. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal;
13. Ministri i Zhvillimit Rajonal;
14. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës;
15. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës;
16. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës;
17. Përfaqësuesi i Agjencisë përkatëse për Investime dhe Ndërmarrje në Kosovë;
18. Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike e Kosovës;
19. Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë;
20. Drejtorja Ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano - Kosovare;
21. Drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropian;
22. Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës;
23. Drejtori Ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës;
24. Drejtori Ekzekutiv i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë;
25. Drejtorja Ekzekutive e Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës G7;
26. Drejtorja Ekzekutive e Shoqatës së Përpunuesve të Drurit;
27. Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Përpunimit të Frutave dhe Perimeve të Kosovës (PePeKo);

28. Drejtorja Ekzekutive e Asociacionit të Kosovës për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (STIKK);
29. Drejtori Ekzekutiv i Kllasterit të Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës (KIMERK).
30. Drejtorja Ekzekutive e Kllasterit të Ndërtimeve të Parafabrikuara të Kosovës.

1.2. Pika 4. e Vendimit zëvendësohet me këtë tekst: "Kryesuesi i Këshillit apo Sekretariati mund të ftojnë edhe pjesëmarrës të tjerë në mbledhjet e Këshillit, të cilët marrin pjesë në diskutim pa të drejtë vote."

1.3. Pika 6. e Vendimit Zëvendësohet me këtë tekst: "Obligohet Sekretariati i Këshillit t'i përgatisë Rregullat dhe Procedurat e Punës së Këshillit, të cilat miratohen nga Këshilli."

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 15/200**
**Datë: 18.04.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Zyrës së Kryeministrit për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej dyqind mijë euro (200,000 €), për realizimin e projekteve përmes marrëveshjeve me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Marrëveshjet me trupat e Organizatës se Kombeve të Bashkuara" me kod 34100, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Zyrën e Kryeministrit me kod 104, në nën-programin "Zyra e Kryeministrit" me kod 10600, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë